LIGJ
Nr. 8221, datë 14.5.1997

PËR RADION DHE TELEVIZIONIN PUBLIK E PRIVAT NË REPUBLIKEN E SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushteruese"

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKES SE SHQ1PERISE

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Ky ligj rreguIlon veprimtarinë e radios dhe televizionit publik e privat në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 2
Veprimtaria radiotelevizive

Veprimtaria radiotelevizive përfshin prodhimin, transmetimin dhe ritransmetimin e programeve dhe informacioneve të çdo lloji me anë të zërit, figurës, sinjaleve të koduara, shkrimit të destinuara për publikun nëpërmjet valëve elektromagnetike, kabllove, satelitëve apo me çdo mjet tjetër.

Neni 3
Baza ligjore e veprimtarisë radiotelevizive

Veprimtaria radiotelevizive zhvillohet në përputhje me Dispozitat Kryesore Kushtetuese, me dispozitat e këtij ligji, të ligjit nr.7524, datë 19.11.1991 "Për statusin e Radiotelevizionit shqiptar" me ndryshimet e mëvonshme, si dhe të ligjit nr. 8038, datë 23.11.1995 "Për telekomunikacionet në Republikën e Shqipërisë". Ajo mban parasysh e respekton gjithashtu dispozitat e tjera ligjore, duke perfshirë ato juridike, civile, administrative dhe penale si dhe për të drejtën e autorit që janë në fuqi në, Republikën e Shqipërisë.

Për të ushtruar një veprinnari radloteIevizive private çdo subjekt fizik a[m juridik duhet të pajiset me licencë.

Neni 4
Parimet themelore të zhvillimit të veprimtarisë radiotelevizive

Veprimtaria e radiotelevizive është e lirë. Ajo respekton partnerisht bindjet politike e besimet fetare,- personalitetin, dinjitetin, jetën private të njeriut si dhe të drejtat e liritë themelore të tij. Në

këtë Veprimtari respektohen në mënvrë të veçantë të drejtat, interesat dhe kërkesat morale e ligjore për mbrojtjen e të miturve. Veprimtaria radiotelevizive nuk lejohet të cënojë rendin publik, sovranitetin dhe integritetin kombëtar.

KREU II
KESHILLI KOMBETAR I RADIOS DHE I TELEVIZIONIT

Neni 5
Këshilli Kombëtar i RT

Për mbikurjen e veprjratarisë radiotelevizive në Republikën e Shqipërisë krijohet Këshilli Kombëtar i RT, i cili është organizëm i pavarur që vepron në bazë e për zbatim të dispozitave të këtij ligji.

Neni 6
Kompetencat

Këshilli Kombëtar i RT ka këto të drejta e detyra:

1. Kontrollon zbatimin e këtij ligji dhe të ligjeve të tjerë për mediat nga subjektet që ushtrojnë veprimtart radiotelevizive, publike e private, në territorin e Republikës së Shqipërisë.
2. U ndan operatoreve radiotelevizivë, publikë e private, kanalet e disponueshëm të frekuencave për veprimtari radiotelevizive.
3. Garanton konkusencen e ndershme në fushën e mediave eleknronike, duke siguruar njëkohësisht egzistencën dhe zhvillImin e mëtejshërn të RT publik shqjptar
4. U jep dhe u heq Licensat subjekteve private, për transmetim programesh radiotelevizive, dukeperfshire teletekstin, në territorin e Republikës së Shcaperisë dhe kontrollon respektimin e kushteve të përcaktuara në license. Vendimet e tij për dhënien e heqjen e licensave botohen në Fletoren Zyrtare.
5. Harton rregulloren me kriteret për dhërden e Licensave në përputhje me këtë ligj. Organizon dhënien e tyre me transparencë dhe garanton barazinë e 6-ajthriit të kërlcuesve. Njofton arsyet e refuzimit , pezullimit ose heqjes së licensës dhe shqyrton ankimin e subjektit të cënuar, i cili ne cdo rast mund t'i drejtohet per ankese gjykates përkatëse.
6. Jep Licensa për instalimin e përsëritsave radiotelevizivë të programeve të huaja për zona të ndryshme të vendit.
7. Jep Licensa për ritransmetim të radiove dhe televizioneve të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë për publilcun shqiptar.
8. L jep autorizime operatorëve publikë dhe privatë shqiptarë për transmetime nga Shqipëria në drejtitn të vendeve të tjera (për të tretë)„cluke respektuar konventat ndërkombëtare.
9. Cakton norma prodhimi dhe transmetimi për mediat publike dhe private lidhur me aspekte të nclryshme të zbatimit të këtij ligji.
10. Vendos zbatimin e sanksipneve të përcaktuara në këtë ligj, që janë në kotnpetencë të tij, për subjektet që veprojnë ne kundërshtim me këto dispozita, si dhe, sipas rastit, kërkon ndërhyrjen e organeve të tjera sipas kompetencës së tyre.
11. Mban regjistrat, skedat dhe arkivin e licensave si dhe dokumentacionin që lidhet me to duke pasqyruar të gjitha ndryshimet e mëvonshme.
12. Kërkon nga administrata shtetërore, gjykatat, bankat dhe organizma te tjera perkates, si dhe nga titullarët e subjekteve të liçensuar çdo informacion që e gjykon të nevojshëm për të kontrolluar vertetesine e te dhenave te prura nga kerkuesi i Licenses para dhenies se saj ose ne cdo

moment tjeter , të dhëna të cilat perdoren vetërn për zbatimiu e detyrave të ngarkuara nga ky ligj. Përhapja dhe botimi i tyre për publilcun e gjerë nuk lejohet.

13. Jep ndihmë për shfrytëzimin racional të brezit të frekuencave për radio e televizion dhe sugjeron ide e mendime për perspektivën e zhvillimit të veprimtarisb radiotelevizive.

14. Shpreh zyrtarisht opinionet e tij për nënshkrimin dhe zbatimin korrekt të marrëveshjeve ndërkombëtare që kanë të bëjnë me transmetimet radiotelevizive.

15. Merr pjesë në aktivitete ndërkombëtare në lidhje me strategjinë dhe perspektivat e zhvillimit të radios dhe televizionit duke përfaqësuar Shqipërinë dhe mbështet pjesëtnarrjen e bashkëpunimin e subjekteve publike e private me organizata homologe evropiane dhe botërore në fushën e programeve dhe transmetimeve radiotelevizive. Përgatit studime me rekomanclime për qëndrimin e Shqipërisë në bisedimet ndërkombëtare qeveritare mbi transmetimet radiotelevizive.

16. Sugjeron ndryshime të legjislacionit dhe të rregulloreve, të cilat diktohen nga evolucioni telmologjik, ekonomik, social dhe lculturor në fushën e mjeteve elektronike të komunikimit masiv. 17. Harton strukturen organizative dhe rregulloren e brendshme të administratës së Këshillit.

18. Raporton në fillim të çdo viti mbi aktivitetin e tij vjetor dhe mënyrën se si janë respektuar nga rrjeti publik dhe privat, detyrimet që rrjedhin nga ky lig.j. Raportin e paraget para Komisionit për Mjetet e Informimit Publik të Kuvendit Popullor dhe kur kërkohet edhe para Kuvendit Populltor. Një raport vjetor i dërgohet Pres1dentittë Republikës dhe Kryetarit të Këshillit të Ministrave.

19. Kontrollon cilësinë e marrjes së sinjaleve në zonat e liçensuara dhe kërkon zgjidhje për ankesat e publikut si për cilësinë e transmetitnit të sinjaleve radioteleviztve ashtu dhe për plotësimin e kërkesave të parashikuara në këtë ligj.

Neni 7

Përbërja

Këshilli Kombëtar i RT përbëhet nga layetari, zëvendëskryetari dhe pesë anëtarë, të cilët janë persorralitete të jetës shoqërore, kulturore, juridike, ekonomike, edukative, të masmedias dhe të teknikës të radioteleviziond Kryetari dhe ZËvendës kryetari i KKRT janë funksionarë. Detyra e anëtarit të Këshillit Kombëtar të RT nuk është detyrë funkSionare. Buxheti financiar i Këshillit Kombëtar të Radios .dhe Televizionit përballoheo nga shteti. Kryetari dhe zëvendëskryetari i KKRT barazohen në pagë me kryetarin dhe zëvendëskryetarin e Gjykitës së Kasacionit. Shpërblirnei për anëtarët e këtjj Këshilli caktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 8

Zgjedhja

Anëtarët e Këshillit Kombëtar të RT zgjidhen nga Kuvendi Popullor për një periudhë pesëvjeçare, jo më tepër se 2 herë rradhazi. Presidenti i Republikës i propozon Kuvendit Popullor kandidaturën për një anëtar, k-urse gjashtë kandidaturat e tjera propozohen nga Komisioni i Përhershëm për Mjetet e Infonnimit Publik në përfaqësim të barabartë midis pozitës dhe opozitës parlamentare.

Kryetari i Këshillit Kombëtar të RT zgjidhet nga Kuvendi Popullor ndërmjet 7 anëtarëve të tij dhe mbi bazën e dy kandidaturave të propozuara me votim të fshehtë nga mbledhja e përbashkët e Komisionit të KP për Mjetet e Infonnimit Publik me Këshillin Kombëtar të RT.

Nënkryetari i Këshillit Kombëtar të RT zgjidhet me votim të fshehtë ndër dy kandidatura andtarësh të KKRT. nga mbledhja e përbashkët e Komisionit të KP për Mjetet e Informimit Publik me Këshillin Kombëtar të RT.

Kryetari dhe Nënkryetari i mandatit të parë të KKRT zgjidhen për një periudhë 6 vjeçare në mënyrë që të sigurohet vijimësia më e mirë e funksionimit të KKRT gjatë ndërrimit pesëvjeçar të anëtarëve në mandatet e ardhshme.

Neni 9
Organizimi

Pranë Këshillit Kombëtar të RT vepron administrata e tij, e cila realizon gjithë veprimtarinë e nevojshme përgatitore e administrative në shërbim të Struktura, organizimi i veprimtarisë, kompetencat dhe detyrat përcaktohen në rregulloren e funksionimit të Këshillit që miratohet prej tij. Struktura miratohet nga Këshilli i Ministrave cili përcakton dhe pagat e administratës së Këshillit.

Neni 10
Papajtueshmëria

Anëtarët e Kombëtar të RT nuk lejohet :

1. Të kenë funksione drejruese në partitë dhe shoqatat politike, të jenë deputetë ose anëtarë të Qeverisë dhe as të deklarohen publikisht apo të veprojnë në interes të tyre.

2. Të jenë anëtarë të shoqërive aksionare që kanë lidhje me mjetet e informinnt masiv ose të përfaqësojnë interesa tregtare që janë në ktmdërshtim me funksionin e tyret

3. Të lidhen me interesa financlare që kanë të bëjnë me transmetimet në radio dhe televizion nëpërmjet prooësise, marreidhënieve të punësintit ose tregtare.

4.Të mbrojnë interesat e një shoqërie apo firme prodhimesh audiovizua1e, botimesh shtypi, reklame ose telekomunikacioni. Punonjësit e administratës së Këshillit Kombëtar të RT nuk lejohet të jenë anëtarë të bordeve administruese të rrjeteve transmetuese publike e private, të jenë të liçensuar për transmaime radiotelevizive, të mbrojnë interesat e një subjekti që ka marrë licensë apo të ushtrojnë funksione në shërbim të tij.

Neni 11
Lirimi nga detyra

1.Titullari dhe anëtari i Këshillit Kombëtar të RT mund të 1irohet nga detyra nga organi që e zgjedh kur: - dënohet nga gjykata me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi. - bëhet i paaftë për të kryer detyrën për shkak sëmundjeje e mtingon në më shumë se 1/3 e mbledhjeve të Këshillit në vit.

2. Titullari dhe anetari i KKRT mund te japë dorëheqjen ne cdo kohë.

3. Ne cdo rast lirimi zgjidhet nje zevendesues duke ndjekur proceduren e parashikuar per emerimin dhe për një kohë tëe barabartë me kohën që i kishte mhetur pararendësit që ai zëvendësoi.

Neni 12
Detyrimi për ruajtjen e sekretit

Anëtarët e Këshillit Kombëtar të RT dhe nëpunësit administrativë të këtij këshilli detyrohen të ruajnë sekretin prcifesional për faktet, informacionet, aktet për të cilat janë vënë në dijeni për shkak të detyrës që ata kryejnë. Për shkeljet në këtë drejtim mbajnë përgjegjësi sipas dispozitave ligjore.

Neni 13

Kuorumi

Mbledhjet e Këshilli Kombëtar të RT mund të zhvillohen vetëm kur janë të pranishëm jo më pak se pesë anëtarë dhe vendimet janë të vlefshme kur për to kanë votuar jo më pak se katër anëtarë të

KREU III
PLANIFIKIMI I FREKUENCAVE PE,R FtADIO DHE TELEVIZION

Neni 14
Përdorimi i brezave të frekuencave

Brezi i frekuencave për transmetimet radioteleviztve është pasuri komhëtare. Planifikimi i kanaleve të frekuencave që i vihet në dispozicion KKRT për programet radiotelevizive bëhet në përputhje me planin kombëtar të ndarjes së spektrit të frekuencave, i cili hartohet nga Komisioni Shtetëror i Radiokomunikacioneve, në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 8038, datë 23.11.1995 "Për telekomunikacionet në Republikën e Shqipërisë" dhe me dispozitat e këtij ligji.

Neni 15
Ndryshimi i frekuencave

Keshilli Kombëtar i RT mund t'u ndryshojë frekuencat përdoruesve të liçensuar prej tij, kur kjo bëhet e nevojshme për arsye teknike ose për shkak të detyrtmeve që njedhin nga marrëveshjet ndërkombëtare të nënshiauara nga vendi ynë. Ndryshimet pasqyrohen në licensë.

Neni 16
Frekuencat për transmetim kombëtar e lokal

Në caktimin e frekuencave për programet radiotelevizive kombëtare rrjeti i transmetuesve duhet të sigurojë mbulimin e më tepër se 65 % të sipërfaqes së Republikës së Shqipërisë, kurse për programe lokale, të sigurojë rnbulimin e më tepër se 75% të sipërfaqes së zonës, për të cilën destinohet transmetimi.

Neni 17
Pezullimi i shfrytëzimit të frekuencave në gjendje të jashtëzakonshme

Kur shpallet gjendja e jashtëzakonshme dhe për sa kohë zgjat ajo, Kryetari i Këshillit të Ministrave me propozim të ministrave të Mbrojtjes, të Brendshem dhe të Kryetarit të Komisionit Shtetëror te Radiokomunikacioneve, mund të urdhërojë që frekuencat e caktuara për personat privatë të licensuar të përdoren përkohësisht nga organet shteterore që kanë nevojë për këto frekuenca,

KREU IV
LICENSIMI

Neni 18
Licensa

Licensa e transmetimit radioteleviziv vlen si leje për instalimin e pajisjeve teknike dhe i jep subjektit privat të drejtën për transmetim. Ajo duhet të permbajë kërkesat e nenit 21 të këtij ligji, të drejtat e detyrimet e subjektit që kërkon të licensohet dhe të përcaktojë kushtet telmike e programore që duhen plotësuar për të realizuar transmetimin. Licensa autorizon shfrytëzimin e rrjeteve të tr-ansmetuesve me shtrirje kombëtare ose lokale dhe përcakton frekuencat e punës, fuqinë, vendvendosjen, zonën e mbulimit si dhe elementë të tjerë që përcakton rregullorja e harwar për këtë qëllim nga Këshilli Kombëtar i RT.

Neni 19

Dhënia e licensës

Licensa u jepet shoqërive aksionare që krijohen në territorin e Republikës së Shqipërisë me synim eksluziv veprimtarinë radiotelevizive, Aksionet që përfaqësojnë kapitalin në një shoqëri mbajtëse të një license radiotelevizive duhet të jenë nominatiye. Asnjë person fizik ose juridik nuk duhet të ketë më shumë se 25% të kapitalit të përgjithshëm të shoqërisë. Asnjë person me shtetësi të huaj nuk mund të jetë përfaqësues apo drejtues i një shoqërie mbajtëse të një license radiotelevizive, as të ketë, direkt apo indirekt, më shumë se 20% të kapitalit apo të të drejtave të votës oë asamb1enë e përgjitbshme të shoqërisë. Një person fizik apo juridik që ka mbi 15% të kapitalit të një shoqërie radiotelevizive, nuk mund të ketë, direkt apo indirekt, më shumë se 15% të kapitalit në një shoqëri të dytë radiotelevizive. Ndalohet huazimi i emrit, në çdolloj mënyre, çdo personi që kandidohet për marrjen e një license për Veprimtari radiotelevizive. Po ashaknuk u jepet licensë personave juridikë e fizikë që zotërojnë kontrollin e ndërmarrjeve botuese të gazetave me tirazh që kalon 10% të tirazhit të përgjithshëm të gazetave në Shqipëri. Licensa jepet nga Këshilli Kombëtar i RT i cili organizon për këtë qëllim konkurim transparent kandidaturash për kanalet e disponuar të frekuencave të transmetimit. Kanalet e ofruara dhe mbledhja e kandidaturave shpallen publikisht. Entet radiotelevizive publike nuk kanë nevojë për. licensë.

Neni 20

Vlefshmëria e licensës

Licensa e transmetimit është e patjetërsueshme dhe vlen vetëm për subjektin të cilit i është akorduar. Në rast se mbajtësi i licensës hyn në marrëdhenie juridike civile, objekt i të, cilave është eclhe veprimtaria radiotelevizive e licensuar, atëhere për cedimin ose kalimin e të drejtave që burojnë nga licensa kërkohet miratimi i Këshillit Kombëtar të RT. Subjektit që ka fituar këto të drejta, miratimi i jepet në formën e.rije license të re me të njëjtën përmbajtje. Kur Keshilli nuk e miraton kalimin, e ofron kanalin e frekuencave për një konkurim të ri kandidaturash.

Neni 21

Kërkesa për licensë

Në kërkesën për marrjen e licensës së trasmetimit radioteleviziv shkruhen:

1. Emërtimi, vencIndodhja, forma ligjore e personit juridik bashkë me emrin dhe firmën e personit që ka të drejtë ta përfaqësojë atë,

2. Dokumentet që vërtetojnë qënien e personit juridik dhe të dhëna zyrtare e bankare mbi kapitalin financiar të personit juridik apo fizik që bën kërkesën. 3. Emërtimi i programit dhe i stacionit transrnetues

4. Objekti dbe karakteristikat e pergjitbshme të shërbimit, të dhëna për kohëzgjatjen e programeve dhe territorin që do të mbuloië si dhe projeknn teknik të instalimit dhe shfrytezimit të aparaturave.

5. Lista e administratortve, parashikimet për shpenzimet dhe të ardhurat, origjinën dhe shumën e financimeve të parashikuara për kohëzgjatjen që kërkohet licensa.

6. Përmbajtja e programeve që do të transmetohen dhe struktura programore e propozuar për transmetim.

7. Raporti i kohës së transmetimit që do të zënë emisionet e prodhuara vetë dhe emisionet e prodhuara në vend në proporcion me emisionet e tjera

8. Kohëzgjatja e licensës.

Neni 22

Vendimi për dhënien e licensës

Vendimi për dhënien ose mosdhënien e licensave jepet brenda 90 ditëve pas datës së mbylljes së dorëzimit të kandidaturave. Për kërkesën që miratohet në vendim shënohen kushtet teknike të transmetimit, përmbajtja e cilësia e programeve në përputhje me këtë ligj, afati dhe tarifat që i caktohen të licensuarit. Vendimi për dhënien e licensës botohet në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë. I licensuari regjistrohet si subjekt tatimor.

Neni 23

Afati i licensës

Licensa për veprimtari radiotelevizive kombëtare jepet për një kohë deri në 6 vjet për tunsmetimet në radio dhe 8 vjet në televizion, duke filluar qysh nga dita e botimit në Fletorën Zyrtare.

Licensa për veprimtari radioteievizive. lokale (zonale) jepet për një kohë deri rre vjet për transmetime radiofonike dhe pesë vjet për transmetime televizive. Kërkesa për rinovirnin e licensësbehet 90 përpara afatit të përfundimit të saj. Keshilli Kombëtar i RT vendos per rinovimin ose për shpalljen e konkurinnt të kandidaturave nëse operatori i licensuar nuk ka qenë i rregullt në zbatimin e këtij ligji.

Neni 24

Mosdhënia e licensës

Licensa nuk u jepet:

1. Personave të dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për një për të cilin kodi penal parashikon dënime rnbi 10 vjet burgira.

2. Partive ose shoqatave politike, si dhe autoriteteve zyrtare publike.

3. Enteve publike me karakter ekonomik, si dhe instituteve të kreditit.

Neni 25

Kufizimi në dhënien e licensës

Nuk i jepet licensë : 1, Subjektit që ka një licensë transmetimi radtofonik apo televiziv kombëtar; 2. Të njëjtit subjekt për më shumë se dy zona transmetimi lokal.

Neni 26

Licensa për radio dhe televizion

Të njëjtit subjekt mund t'i jepet licensë për transmetim për radio dhe televizion lokal në të njëjtin territor (zonë).

Neni 27
Kushtet financiare për dhënien e licensës

Për transmetime radiotelevizive në shkallë kombëtare, licensa jepet vetëm për subjekte të cilat kanë kapital të vërtetuar në masën:

1. jo më pak se 20 milionë lekë për transmetim radiofonik, dhe
2. jo më pak se 100 milionë lekë për transmetim televiziv.

Për transmetimet radiotelevizive lokale (zonale) subjek-tet kërkues duhet të japin një garanci financiare jo me të vogël:

1. 4 milionë lekë për transmetim radiofonik;
2. 10 milion lekë për transmetim televiziv.

Neni 28
Kushti për përmbajtjen e programeve

Për marrjen e licensës me shtrirje lokale (zonale) duhet që të paktën 25 për qind e programeve javore të jenë për informacionin dhe për programe që lidhen me realitetin lokal, por që nuk kanë karakter tregtar.

Neni 29
Detyrimi për njoftiadn e ndryshimeve

I licensuari detyrohet të njoftojë Këshillin Kombëtar të RT për çdo ndryshim të të dhënave që ka paraqitur në kërkesën për marrjen e licensës, ose për mosplotësimin e kushteve të caktuara në licensë duke dhënë dhe arsyet përkatëse paraprakisht dhe në cdo rast jo më vonë se 15 ditë pas bërjes së këtyre ndryshimeve.

Neni 30
Ndryshimi i detyruar i kushteve të licensës

Këshilli Kombëtar i RT ndryshon kushtet e përmendura në licensë pa miratimin e mbajtësit të saj, kur këto ndryshime diktohen nga respektimi i marrëveshjeve ndërkombëtare, që ka nënshkruar Republika e Shqipërisë.

Neni 31
Fillimi i transmetimit

Transmetimi në bazë të licensës së dhënë fillon vetëm pas inspektimit teknik të projektit dhe të pajisjeve nga Këshini Kombëtar i RT, i cili konfirmon zyrtarisht me shkrim përputhjen e kushteve të licensës me ato të realizuara faktikisht.

Neni 32
Pavlefshmëria e licensës

Licensa bëhet e pavlefshme kur:

a) Mbaron afati i vlefshmërisë dhe ajo nuk është rinovuar.

b) i licensuari heq dorë prej saj zyrtarisht. Kombëtar i Radios dhe i Televizionit ka nxjerrë vendim për heqje license në bazë të kompetencave që i jep ky ligj.

d) Deklarohet falimentim.

e) Kërkuesi nuk e tërheq licensen ose nuk realizon detyrimet fmanciare të parashikuara në këtë ligj pas 60 ditëve nga momenti kur merr dijeni zyrtarisht për miratimin e saj.

Neni 33

Heqja e licensës

Keshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit ka të drejtë të heqë licensën e transmetimit kur:

1. Eshte fituar sipas të dhënave të rreme të paraqitura në kërkesë.

2. Nuk plotësohen kushtet për të cilat është dhënë licensa.

3. Cënohen rëndë detyrimet e caktuara në këtë ligj ose detyrime të tjera ligjore që lidhen me transmetimin e programeve cihe në perputhje me Nenin 78 të këtij ligji.

4. Nuk ka filluar transmetim mbas hyrjes në fuqi të vendimit për dhënie 1icense për një periudhë kohe: - 180 ditë në twsmetimet e rachos; - 270 ditë në transmetimet e televizionit.

5. Pas fillimit të transmetimit, gjatë një viti kalendarik nuk transmetohet 30 ditë pa llogaritur ndërpjerjet për arsyet teknike që nuk varen nga mbajtësi i licenses.

6. Tek mbajtësi i licenses kanë ndodhur ndryshime që e bëjnë të pamundur respektimin e kushteve të vendosura në license.

7. Prona e mbajtësit të licensës ka dalë në ankand për shitje. Kur hiqet licensa e transmetimit, mbajtësi i saj është i detyruar ta ktheje atë, pa kërkuar demshperblim nga Këshilli Kombëtar i RT.

KREU V

PROGRAMET RADIOTELEVIZIVE

Neni 34

Programi radioteleviziv

Programi radioteleviziv është tërësia e emisioneve me karakter informativ, edukativ, kulturor, anisitik, argëtues e reklamues që transmetohen nga një stacion i caktuar. Në programet radiote1evizive nuk lejohet censura, përveç kufizimeve të parashikuara me ligj, e në përputhje me Nenin 10 të Konventës Evropiane për lvlbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut.

Neni 35

Programet radiotelevizive, publike dhe private, detyrohen të respektojne dinjitetin personal të njeriut dhe të drejtat themelore të të tjerëve, ndershmërinë, vërtetësinë dhe pluralizmin e informacionit, mbrojtjen e fëmijëve dhe të adoleshentëve, mbrojtjen e rendit publik dhe interesat kombëtare shqiptare, gjuhën dhe kulturën shqiptare, mbrojtjen e të drejtave kushtetuese e njerezore të pakicave kombëtare në përputbje me konventat ndërkombëtare të nënshkruara nga Shqipëria, diversitetin fetar të botës shqiptare.

Neni 36

Përdorimi i gjuhës shqipe është i detyruar për të gjitha programet, përveç veprave muzikale me tekst në gjuhë të huaj, emisioneve për mësimin e gjuhëve të huaja, ernisioneve drejtuar posaçërisht për pakicat kombëtare. Filmat në version brigjinal duhet të transmetohen të shoqëruar me përkthimin në gjuhën shqipe.

Neni 37

Programet me origjinë evropiane duhet të zënë jo më pak se 60% dhe ato mbi botën shqiptare jo më pak se 40% të kohës së transmetimit, duke përjashtuar kohën e rezervuar për lajmet, sportet, lojërat, reklamat dhe teletekstin. Ky proporcion, duke pasur parasysh përgjegjësitë e transmetuesit ndaj kërkesave informuese, edukuese, kulturore e argëtuese të shikuesve e dëgjuesve duhet të arrihet progresivisht mbi bazën e kritereve të përshtatshme që do të përcaktohen nga Këshilli Kombëtar i RF dhe në mënyrë të veçantë për orët e shikitnitr degjimit më të madh.

Neni 38

Programet e ndaluara me ligj

Në RT nuk lejohet të jepen programe që nxisin dhutfen, luftën agresive, urrejtjen kombëtare e raciale, prishjen e rendit publik, ndatjen territoriale, diskriminimin politik ose fetar si dhe ato që me qëllim ngjallin panik. Nuk lejohet: 1. Transmetirui i informacioneve, të cilat përbëjnë sekret shtetëror sipas ligjit, dhe që i sjellin dëm sigurisë kombëtare. 2. Transmetimi i mesazheve të shifruara kundër interesaVe themelore të shtetit. 3. ProdhiEni e transmetimi i programeve pornografike.

Neni 39

Informacionet që transmetohen pa shpërblim

Këshilli Kombëtar i RT percaidon mesazhet me dobi shocidrore apo me interes të lartë për administratën sineterores që rrjetet radiotelevizive publike ose private detyrohen t'i transmetojnë pa shpërblim. Transmetohen detyrimisht me përparësi dhe falas nga radiotelevizioni publik komunikatat dhe mesazhet me interes të iartë publik të dhëna nga Kuve,tdi Popullor, Presidenca e Republikës dhe Këshilli i Ministrave. Organet e pushtetit dhe të administratës shtetërore lokale kanë të drejtë t'u kërkojnë të licensuarve për transmetime radiotelevizive lokale private, që të transmetojnë pa shpërblim komunikata të shkurtra që paraqesin interes të veçantë për publikun e zonave ku ato transmetojnë dhe që kanë të bëjnë sidomos me shëndetësinë, fatkeqësitë natyrore, rendin, etj. Transmetuesit nuk mbajnë përgjegjësi për përmbajtjen e këtyre mesazheve.

Neni 40

Kohëzgjatja e transmetimit për programet private

Transmetimet e programeve në radio ose televiz,ion privat lokal detyrimisht duhet të kenë këtë kohëzgjatje:

1. Jo më pak se 6 orë në ditë transmetime në radio.

2. Jo më pak se 4 orë në ditë transmetime në televizion.

Transmetimet e programeve në radio ose televizion privat në shkallë kombëtare, detyrimisht duhet të kenë këtë kohëzgjatje:

1. Jo më pak se 10 orë në ditë transmetime në radio.

2. Jo më pak se 6 orë në ditë transmetime në televizion. Nuk konsiderohen programe transmetimet thjesht përsëritëse ose ato qe jane me figura fikse.

Neni 41

Transmetimi i lajmeve dhe arkivimi

Radio dhe televizioni publik në shkallë kombëtare, detyrohet të transmetojë çdo ditë laj me. Lajmet që jepen në radio e televizion (publik e privat, kombëtar e lokal) duhet të rregjistrohen e të ruhen për një periudhë 2 mujore pas ditës së transmetimit. Për çdo program tjetër të rregjistruar zbatohen dispozitat e ligjit nr.7726, dt.29.6.1993, "Per fondin arkivor kombëtar dhe për arkivat".

Neni 42

Transmetimi i filmave

Veprat kinematografike (përveç rasteve me marrëveshje midis transmetuesit dhe atij që ka të drejtën e autorit) mund të transmetohen në televizion vetëm 2 vjet pas shfaqjes së parë të kësaj vepre në sallat kinematografike të vendit të origjines. Për veprat e prodhuara në bashkëpunim me kompaintë televizive, ky afat reduktohet në një vit, kur me marrëveshje nuk vendoset ndryshe. Filmat dhe programet që janë të ncialuara të shfaqen në kinema nuk mund të shfaqen në televizion. Filmat e ndaluar për fëmijët nën moshën 14 vjeç nuk mund të shfagen në televizion as pjesërisht para orës 23.00 dhe pas orës 6.00. Në transmetimet e filmave zbatohen kërkesat e ligjit nr. 8096, datë 29.04.1996, "Për Kinematografutë".

Neni 43

Fshehtësia e burimeve të informacionit

Fshehtësia e burimevc të informacionit (përfshirë edhe materialet e hulumtuara nga gazetarët) është e garantuar. i tyre bëhet vetëm në raste të veçanta e të parashikuara me ligj.

Neni 44

Përgjegjësia për programin e transmetuar

Gazetari e titullari përgjegjës i materialit të transmetuar me radio ose televizion, publik ose privat, mbajnë përgjegjësi sipas rastit, penale ose civile, kur nga pavërtetësia e informacionit ose e programit të transmetuar u janë shkaktuar personave juridikë ose privatë dëme materiale ose morale.

Neni 45

E drejta për përgënjeshtrim

Personi i prekur në interesat e tij morale ose materiale nga transmetimet e pavërteta, ka të drejtë t'i kërkojë transmetuesit radioteleviziv, publik ose privat, që të japë respektivisht në radio ose në televizion përgjigjen pergënjeshtruese. Përgjigja duhet të nënshkruhet nga pala e interesuar ose përfaqësuesi i saj ligjor dhe t'i përmbahet vetëm fakteve për të cilat ai e konsideron veten të prekur, pa përmendur në se do të kërkojë apo jo ndjekje penale për këtë gjë. Nuk jepet e drejta e përgjigjes kur faktet për të cilat personi e quan veten të prekur kanë dalë gjatë sesioneve të Kuvendit Popullor apo gjatë gjykimeve në gjykatë. Përgjigja transmetohet pa pagesë në edicionin e ardhshëm të të njëjtit program ose të të njëjtës kategori programesh. Për mosrespektimin e kësaj të drejte përgjegjësi i emisionit ndëshkohet sipas sanksioneve të parashikuara në këtë ligj. Përgjigja mund të refuzohet të jepet në radio ose në televizion kur:

I . personi i interesuar nuk ka interesa legjitime për publikimin e saj;

2. përgjigja është shumë më e gjatë sesa deklarata cilësuese për të cilën kërkohet të jepet përgjigja;

3. kërkesa për përgjigje nuk është bërë brenda 2 muajve nga dita që është clhënë deklarata që kundërshtohet.

Neni 46

Bilancet vjetore dhe përmbajtja e tyre

Operatorët radiotelevizivë publikë e privatë janë të detyruar të hartojhë bhancet e tyre vjetore. Në to pasqyrohen të dhëna për programet e transmetuara, çmimet e tyre kur ato janë blerë ose shuma e harxhuar kur ato janë programe origjinale, të dhëna për reklamën e transmetuar ose veprimtari të tjera dhe të ardhurat përkatëse, sponsorizimet, si dhe lista e fmancuesve apo dhuruesve me shumën pdrkatëse dhe çdo shpërblim tjetër në favor të subjektit radioteleviziv publik ose privat. Kur në bilanc konstatohen tregues të rremë, personi përgjegjës përg,jigjet penalisht.

KREU VI
REKLAMA

Neni 47

Reklarnë është çdo mesazh që synon të nxisë shit-blerjen e një malli ose kryerjen e një shërbimi duke paraqitur një ide për të arritur efektet që dëshiron reklamuesi, të cilit i është thhënë kohë transmetimi me pagesë ose me një formë tjetër shpërblimi.

Neni 48

Kushtet për reklamën

Transmetuesit radiotelevizivë detyrohen të sigurojnë që reklamat:

1. të jene me folës shqip ose me subtitrime shqip;
2. të jenë të ndershme e të mos bëhen duke dëmtuar të tjerët;
3. të mos jeuë mashtruese dhe të mos paragjykojnë interesat e konsumatorëve;
4. të mos bëhen nga spikerët e rregullt të lajmeve ose të paraqitjes së programeve;
5. në masën 40% të jenë prodhuar në Shqiperi. Nuk lejohen reklamat subliminale (që veprojnë në subkoshiencën e shikuesit dhe për shkak të shpejtësisë së transmetimit nuk kapet nga shqisat e njeriut).

Neni 49

Forma e paraqitjes së reklamave

Reklamat transmetohen andis e brenda programeve të mhyshme, si dhe në programe të veçanta (programet-reklamë). Në radio transmetimet e reklarnave veçohen qartë, me ndilunën e mjeteve akustike nga pjesët e tjera të programit, kurse në televizion me ndihmën e mjeteve optike dhe akustike. Në parim ato transmetohen në blloqe. Lejohet transmetimi i prograineve-reldarnë në qoffe se shprehet qartë karakteri reklamues i programit dhe reklama është pjesë thelbësore e tij. Programi-relclamë prezantohet si i tillë në fillim të emisionit dhe shoqërohet në fund me shënimin "program-reklamë".

Neni 50

Ndërfutja e reklamave

Reklamat mund të futen midis programeve si edhe, në rastet e përshkruara më poshtë, brenda programeve por duke mos dëmtuar integritetin dhe vlerën e tyre. Në programe që përbëhen në pjesë autonome, ose në programe kulturore-sportive dhe ngjarje të tjera të tilla të ngjashme që përmbajnë intervale, reklamat ndërfuten vetëm midis pjesëve ose në intervalet. Në programet e tjera çdo ndërprerje për reklama nuk do të bëhet pa kaluar të paktën 20 minuta nga ndërprerja pararendëse. Transmetimi i filmave (duke përjashtuar dokumentarët), kur zgjasin më shumë se 45 minuta, mund të ndërpritet një herë për çdo periudhë të plotë 45 minutshe me reklama që nuk i kalojnë blloqet e 2 minutave. Ndërprerja tjetër lejohet nëse fdmi vijon të paktën edhe 20 minuta pas dy ose më shumë periudha 45 minutëshe. Reklamat nuk ndërfuten në asnjë transmetim shërbimi fetar. Emisionet e lajmeve, dokumentaret e programet e fëmijëve që janë më pak se gjysëm ore nuk duhet të ndërpriten nga transmetimi i reklamave.

Neni 51

Kohëzgjatja e transmetimit të reklamave

Koha e transmetirnit të reklamave në televizion nuk duhet të kalojë 15% të kohës ditore të transmetimit. Koha e transmetimit të reldamave televizive gjatë një ore të dhënë transmetimi nuk duhet t'i kalojë 12 minutat. Koha e transmetimit të reklamave në radio nuk duhet të kalojë 10% të kohës së përgjithshme të transmetimit.

Neni 52

Arkivimi i reklamave

Reklamat e transmetuara ruhen të rregjistruara sipas radhës së tyre për një kohë njëvjeçare nga dita e nansmetimit.

Neni 53

Dispozita ndaluese për reklamat

Nuk lejohet të transmetohen në radiotelevizion:

1. reklamat që ushtrojnë ndikim në përmbajtjen e programeve;
2. reklamat që nxitin pornografinë dhe dhunën;
3. reklamat e produkteve të duhanit;
4. reklamat për armatimet dhe pajisjet ushtarake;
5. reklamat indirekte;
6. reklamat që nxisin shqetësime publike;
7. reklamat fetare ose ateiste;
8. reklamat e partive ose shoqatave politike, përveç rasteve të parashikuara me ligj.

Neni 54

Mbrojtja e të miturve

Nuk lejohet të jepen në radiotelevizion reklarna që nxisin sjellje të cilat rrezikojnë shendetin dhe zhvillimin normal psikik të fëmijëve. Reklamat e destinuara për femijet ose kur realizohen me femije, të jenë të tilla që të shmangin çdo gjë që dërnton interesat dhe veçantinë e moslies së tyre.

Neni 55

Reklamat e pijeve alkolike

Relclamat e pijeve alkoolike të të gjitha llojeve u nënshtrohen këtyre kushteve: 1. Të mos u drejtohen në veçanti fëmijëve, dhe ata nuk lejohet të paraqiten në reklamë me pije alkoolike në duar ose në ndonjë mënyrë tjetër. 2. Të mos reklarnohet konsumi i alkoolit në lidhje me pergatitjen fizike dhe energjinë apo me vlera terapeutike. 3. Të mos lavdërohet përqindja e alkoolit në pijet e reklamuara. 4. Të mos trajtohet negativisht moskonsumimi ose konsumi i vogël i alkoolit.

Neni 56
Reklamat per barnat mjekësore

Ndalohen reklamat për barnat dhe trajtim mjekesor të cilat jepen ose kryhen vetëm me recetë mjeku. Ndalohen reklamat për barnat rnjekësore që nuk jane prodhuar e miratuar sipas dispozitave ligjore në fuqi. Reklamat për barnat mjekësore të paraqesin në mënyrë të saktë e të plotë efektet e tyre vetëm sipas të dhenave e verifikimeve të deklaruara nga organet kompetente e sipas ligjeve përkatëse.

KREU VII
SPONSORIZIMI

Neni 57
Sponsorizimi

Sponsorizim është financimi direkt ose jo direkt nga një person fizik ose juridik programi radioteleviziv me qëllim që të reklamojë emrin, firmën prodhuese ose imazhin e këtij personi. Ky i fundit nuk duhet të jetë i përfsbirë rië veprimtari radiotelevizive ose në prodhimin e veprave audiovizuale.

Neni 58
Pasqyrimi i sponsorizimit

Kur një program ose seri programesh sponsorizohet plotësisht ose pjesërisht, kjo duhet të dalë e qartë në shënimet përkatëse në fillim dhe/ose në fund të programit.

Neni 59
Pavarësia nga sponsorizuesi

Në përmbajtjen dhe kohën e programeve të sponsorizuara sponsorizuesi nuk lejohet të ndërhyjë në asnjë rast për të ndikuar në përgjegjësinë dhe pavarësinë redaksionale të emisionit të sponsorizuar.

Neni 60
Ndalesa për sponsorizuesin

Në programet radiotelevizive të sponsorizuara nuk lejohet të bëhen referenca të veçanta për të nxitur shitjen ose blerjen, marrjen ose dhënien me qera, si dhe preferimin e shërbimeve të sponsorizuesit ose të një pale të tretë.

Neni 61
Ndalimi për sponsorizimet

Nuk lejohet të sponsorizohen programet nga persona juridikë ose fizikë, kur veprimtaria kryesore e tyre është prodhimi, shitja ose ofrimi i shërbimeve, relclambni i të cilave ndalohet sipas këtij Emisionet e lajmeve dhe të ngjarjeve të ditës nuk sponsorizohen.

KREU VIII
PROGRAMET RADIOTELEVIZIVE ME KABËLL

Neni 62
Përkufizimi i programeve radiotelevizive nte kabëll

Programe radiotelevizive kabllore janë transmetimi i zerit, figurës ose i të dyjave bashkë nëpërrnjet një sistemi shpërndarës kabllor për tnarrje të njëkohshme të këtyre programeve nga dy ose më shumë pajtimtare.

Neni 63
Përmbajtja e programeve radiotelevizive me kabëll

Programet radiotelevizive kabllore përfshijnë:

1. Ritransmetim të programeve qe jepen në efir nga transmetues tokësorë dhe satelitorë, duke përfshirë gjithmone programe të operatorëve publikë.
2. Ritransmetim të programeve të destinuara për qarqe të mbyllur televizivë.
3. Ritransmetim të prodhimeve audiovizive të regjistruara me mjete të ndryshme.
4. Transmetim të programeve të ndryshme të prodhuara vetë.

Neni 64
Licensa

Licenca për transmetim të programeve radiotelevizive kabllore jepet nga Këshilli Kombëtar i RT për një kohe prej 6 vjetësh. Ajo mund të rinovohet me kërkesën e mbajtësit të licensës, e cila dubet të bëhet 3 muaj para përfundimit të licensës së parë. Në licensë përshkruhet natyra e programeve që do të transmetohen, duke përcaktuar të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga ky ligj. Të drejtat e të tretëve, veçanërisht të drejtat e autorit nuk preken. Subjektet që marrinlicensë për transmetim radioteleviziv kabllor detyrohen të paguajnë taksat, sipas përcaktimeve në ligjet përkatëse.

Neni 65
Procedura për marrjen e licensës

Proçedura dhe kërkesat e tjera të nevojshme për marrjen e licensës, si clhe të drejtat e detyrimet e subjekteve janë të njëjta me ato që parashikohen për licensat e transmetimeve radiotelevizive në efir, të përshkruara në kreun IV të këtij iigji.

Neni 66
Përdorimi i linjave kabllore

Personat juridikë ose fizikë që kanë marrë licensë për transmetim radioteleviziv kabllor, iërdorin linjat kabllore të operatorëve të shërbimit publik. Kur. nuk ka linja të disponueslune për këtë qëllim, instalimi dhe shfrytëzimi i rrjeteve kabllore për transmetim radloteleviziv, bëhet me leje të posaçme nga organet kompetente.

Neni 67

Rregullat e shpërndarjes me kabëll të programeve radiotelevizive

Per të realizuar transmetim cilësor të zërit dhe figurës për pajtimtarët, Këshilli Kombëtar i RT, në bashkëpunim me administratorët e shërbimeve kabllore të telekomunikacionit, iffircalaon rregullat dhe mënyrat e shpërndarjes së programeve radiotelevizive.

Neni 68

Leja për rrjetin kabllor

Leja për vënien në punë të rrjetit kabllor për transmetim radioteleviziv jepet nga autoritetet e telekomunikacionit në dy etapa: 1. Leja paraprake jepet nga organi shtetëror që jep licensa për telekomunikacionet, brenda 15 ditëve nga data e kërkesës, duke u bazuar në licensën e transmetimit të Iëshuar nga Këshilli Kombëtar i RT si dhe në projekiin e rrjetit kabllor për transmetim. Në lejen paraprake caktohet afati për përfundimin e punimeve. 2. Leja përfundimtare jepet brenda 30 ditëve nga data e përfundimit të punimeve dhe pasi të jetë bërë kontroni i zbatimit të projektit teknik dhe i pajisjeve të instaluara.

KREU IX

PERSERITESIT RADIOTELEVIZIVË PËR PROGRAMET E HUAJA

Neni 69

Përsëritësit e programeve radiotelevizive

Përsëritësit janë aparatura transmetimi të destinuara kryesisht për marrjen dhe ritransmetimln e plotë, të pandryshuar dhe të njëkohshëm në efir, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, të programeve radiotelevizive që transmetohen nga stacionet e huaja në rrugë tokësore ose satelitore.

Neni 70

Kushtet për instalimin e pajisjeve përsëritëse

Instalimi dhe shfrytezimi i pajisjeve përsëritëse bëhet vetëm pasi është dhënë licensa përkatëse nga Këshilli Kombëtar i RT. Në caktimin e frekuencave kanë përparësi kërkesat e transmetuesve radiotelevizivë publikë e privatë kombëtarë.

Neni 71

Kushtet për licensën

Licensa për transmedme radiotelevizive me përsëritës jepet pasi të plotësohen këto kushte:

1. Kërkuesi të ketë shtetësi shqiptare.
2. Kërkuesi të gëzojë të gjitha të drejtat civile.
3. Veprimtaria kryesore të ushtrohet në territorin e Republikës së Shqipërisë.
4. Stacionet e huaja të transmetuara nga përsëritësit të mos jenë instaluar me qëllim që të

transmetojnë programe për territorin e Shqipërisë dhe programet e tyre mos të nxisin cënimin e rendit publik e kushterues të Republikës sonë.

5. Përsëritësit të plotësojnë normat e mbrojtjes nga fatkeqësitë si dhe normat teknike ltdhur me instalimet elektrike.

5. Të paraqitet projekti tektik i instalimit të përsëritësve.

6. Karakteristikat teknike të përsëritësve të jenë në pajtueshmëri me normat ekzistuese për transtnetimet radioteleviztve në vendin tonë dhe me normat teknike të rekomanduara nga organizmat ndërkombëtare të spectalizuara në fushën e standarteve.

Neni 72

Anullimi i licensës

Licensat e dhëna për transmetime radiotelevizive me përsëritës anullohen kur: 1. Nuk plotësohet qoftë edhe një nga kushtet për dhënien e licensës. 2. Konstatohen parregullst të rënda ose të përsëritura në zbatimin e kushteve të vëna në licensë . 3. Nuk zbatohen urdhrat e dhëna nga organet shtetCrore kompetente për marrjen e masave e plotësimin e detyrimeve që vë ky ligj. 4. Konstatohen veprime të qëllimshme për të penguar marrjen e masave e për plotësimin e detyrimeve sipas këtij ligji.

Neni 73

Numri i lejueshëm i përsëritësve

Këshilli Kombëtar i RT cakton numrin e kanaleve të përsëritësve për transmetime radiotelevizive që lejohen të funksionojnë për çclo zonë të territorit të Republikës.së Shqipërisë.

Neni 74

Ndryshimet në licensa për interes publik

Për nevoja të zhvillimit të radios dhe të televizionit publik e privat kombëtar, Këshilli Kombëtar i RT ka të drejtë të anullojë licensat e dhëna për përsëritës të veçantë. ose të caktojë Ovendosjen e tyre në një kanal tjetër.

Neni 75

Moslejimi i ndryshimit të destinacionit të përsëritësve

Nuk lejohet ndryshimi i destinacionit të përsëritësve, për t'i përdorur ata si transmetues të programeve radiotelevizive.

Neni 76

Moslejimi i ritransmetimit nte kabëll i programeve satelitore nga individë

Nuk lejohet ritransmetimi me kabëll për qëllime fitimi i programeve satelitore nga individë që kanë pajisje marrëse të tilla.

Neni 77

Anullimi i lejeve të dhëna deri në hyrjen në fuqi të ligjit

Të gjitha lejet për transmetime radiotelevizive me përsëritës që janë dhënë para hyrjes në fuqi

të këtij ligji anullohen. Vijimi i mëtejsbem i puuës së tyre do të lejohet pasi të merret licensa nga Këshilli Kombëtar i RT.

KREU X
SANKSIONET

Neni 78

Në rastet e shkeljes së dispozitave detyruese të këtij ligji, Këshilli Kombëtar i RT vendos sanksione administrative si më poshtë:

1. Transmetim i detyrueshëm komunikate paralajmëruese ose qortuese në transmetuesin e operatorit,
2. Gjobë, jo më shumë se 3% të xhiros vjetore të të ardhurave.
3. Pezullim i përkohshëm i licensës.
4. Reduktim i kohes së licensës.
5. Heqje e licensës. Kur Këshilli Kombetar i RT konstaton shkelje të dispozitave ligjore, vendosja e sanksioneve për të cilat është kompetence e organeve të tjera shtetërore, atëherë ai informon këto të funclit. Operatori i ndëshkuar mund të kundërshtoje vendimin e Këshillit Kombetar të RT në rrugë gjyqësore brenda një muaji nga data e marrjes njoftim për ndëshkimin.

Neni 79
Dispozita kalimtare

Dispozitat për dhënien e licensave zbatohen 12 muaj pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Radiot dhe televizionet private që deri në datën 14 maj 1997 kanë ushtruar veprimtari te palicensuar sipas kerkesave të ketij ligji mund te mos e ndërpresin ate deri në daten 14 maj 1998.

Neni 80
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi në datën 14 maj 1997.

Shpallur me dekretin nr.1792, datë 15.5.1997 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha